



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Elbasan, më _____.____.2024

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E
ANKIMIMIT**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Drejtuar: “4 S” sh.p.k. me nipt L64425401K, me adrese, **Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja
Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria
nr.23/104-N4**”

Operatorit Ekonomik 4 S” sh.p.k. me nipt L64425401K ose

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar- Marreveshje Kuader.

Numri i referencës së procedurës/lotit: Loti IV: REF-26285-10-24-2024

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 25.10.2024

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike : *data 28 tetor 2024 , Buletini Nr.71*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti IV: Blerje mish për Qendren Sociale, Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj **me fond limit: 3.145.833** (tremilion e njëqind e dyzet e pesë mijë e teteqind e tridhjetë e tre) **lekë pa tvsh.**

Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontrave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.

Shumatorja e çmimeve për njësi është: **1.375** (njemijë e treqind e shtatedhjetë e pese) **lekë pa tvsh.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “4 S” sh.p.k. me Nipt: L64425401K

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **1.250** (njëmije e dyqind e pesëdhjetë) **lekë** (pa tvsh).

2. “KAZAZI - MEAT” sh.p.k. me Nipt: K73609801E

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **2.673.900** (dymilion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tremijë e nëntëqind) lekë (pa tvsh).

Ofertues të skualifikuar “KAZAZI - MEAT” sh.p.k. me Nipt: K73609801E

Në dokumentat standarte të tenderit është parashikuar që ofertimi nga operatorë ekonomikë **do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Si rrjedhim, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur KVO konstatoi se ofertimi në formularët e paraqitur, shtojca 1 - Formulari i ofertës dhe shtojca 2 - Lista e çmimeve të artikujve

është bërë me çmim total dhe jo me shumatoren e çmimeve për njësi, çka bie në kundërshtim me parashikimin e kriterit të vlerësimit, i cili do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi, prandaj dhe shtojca 1 - Formulari i ofertës dhe shtojca 2 - Lista e çmimeve të artikujve duhet të kishin si çmim të ofruar shumatoren e çmimeve për njësi.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **"4 S" sh.p.k. me nipt L64425401K**, me adrese, **Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4**, se oferta e paraqitur me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar prej **1.250** (njëmijë e dyqind e pesëdhjetë) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

Konceptoi: Pergjegjës : E.Sanço

Konfirmoi: Drejtori: O. Kokunja

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Asim Sula**